



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 korrik 2015
Nr. ref.: RK 810/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI16/15

Parashtrues

Dragomir Eraković

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-14-0044,
të 5 shtatorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Dragomir Eraković nga Mitrovica (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave DHPGJS), AC-I-14-0044, të 5 shtatorit 2014, i cili i është dorëzuar atij më 17 tetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me këtë Aktvendim janë shkelur nenet 24, 31, 32, 46, 54, 159 dhe 160 të Kushtetutës, si dhe nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe pika 1 e Protokollit I të kësaj Konvente (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës njëkohësisht kërkon vendosjen e Masës së përkohshme, me të cilën Gjykata do të *“suspendojë procedurën e likuidimit në mënyrë që të shmanget shkaktimi i dëmit të pariparueshëm”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 shkurt 2015, parashtruesi përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI16/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin KSH. KI16/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 29 prill 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Ankesave të DHPGJS për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 1 korrik 2015, me Vendimin GJR. KI16/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati në Gjykatën Kushtetuese më 26 qershor 2015.
10. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 28 dhjetor 1992, ndërmarrja shoqërore "Bair" e ka kryer transformimin pronësor në shoqëri aksionare në pronësi të përzier dhe është regjistruar në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë si SH.A. "Tabak", ku si drejtor i ndërmarrjes dhe përfaqësues i autorizuar është emëruar Dragomir Eraković.
12. Me transformimin pronësor të ndërmarrjes shoqërore "Bair", të punësuarit në ndërmarrje kanë fituar pronësinë e përgjithshme mbi 8584 aksione, gjë që në kapitalin e tërësishëm përbën 49% të aksioneve. Pjesa e mbetur e aksioneve ishte në pronësi të SHA "Duvan" Ljubovija (40%) dhe Fondit për Zhvillim të Serbisë (11%).
13. Në periudhën 1999 – 2001, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, kjo ndërmarrje kalon nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (tani Agjencia Kosovare e Privatizimit), dhe më 12 shtator 2001 regjistrohet ndërmarrja e re "N.P.G.P.D. BAIR".
14. Më 14 prill 2008, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) njoftimin për qëllimin e ushtrimit të padisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), për t'i mbrojtur të drejtat e fituara me transformimin pronësor, i cili është kryer më 28 dhjetor 1992.
15. Më 31 janar 2012, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e drejtorit të "SH.P.K Tabak" parashtrroi para DHPGJS-së padinë nr. SCC-12/048 kundër AKP-së për *"kompensimin e dëmit për shkak të drejtave pronësore të cenuara dhe kërkesave të pamundësuar"*.
16. Më 23 maj 2013, AKP-ja nxori aktvendimin me të cilin njofton të gjithë të interesuarit se ka filluar procedura e likuidimit të ndërmarrjes së porsaformuar "N.P.G.P.D. BAIR". Njëkohësisht, AKP-ja fton *"të gjithë kreditorët dhe pronarët, si dhe të gjithë personat që pretendojnë se kanë të drejtën e kërkesës apo interesit ndaj kësaj ndërmarrje apo aseti të ndërmarrjes, t'i paraqesin dëshmitë e kërkesës, duke filluar prej datës 17 qershor 2013 deri më datën 31 korrik 2013"*.
17. Më 30 shtator 2013, DHPGJS urdhëron parashtruesin e kërkesës që të *"prezantojë autorizimin me të cilin e autorizon përfaqësuesin e tij në procedurën para DHPGJS-së, si dhe dëshminë se autorizimi i tillë është lëshuar nga personi i cili është i autorizuar për këtë sipas ligjit të aplikueshëm"*.
18. Me të njëjtin urdhër, parashtruesi i kërkesës është njoftuar se në qoftë se ai nuk vepron sipas urdhrit të DHPGJS-së, padia e parashtruesit do të hidhet poshtë si e papranueshme.
19. Më 14 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në DHPGJS-në autorizimin të cilin ia kishte dhënë z. Goran Milenković. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës në autorizimin nuk është thirrur në statusin e tij të drejtorit të "SH.P.K. Tabak", as nuk kishte dorëzuar ndonjë dëshmi me të cilën do të kishte dëshmuar se

parashtruesi i kërkesës është person i autorizuar për të nënshkruar autorizimin në emër të “SH.P.K. Tabak”.

20. Më 29 janar 2014, DHPGJS mori Aktvendimin (nr. C-I-12-0004), me të cilin hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë se posedon legjitimitetin aktiv në kontest, siç është kërkuar me urdhrin e DHPGJS-së, të 30 shtatorit 2013.
21. Më 14 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti një ankesë në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS, me të cilën kërkoi përsëritjen e procedurës dhe anulimin e Aktvendimit të DHPGJS (nr. C-I-12-0004).
22. Më 5 shtator 2014, Kolegji i Ankesave të DHPGJS me Aktvendimin (nr. AC-I-14-0044) e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetim:

“... se paditësi ka mundur lehtë t’i paraqesë këto dëshmi gjatë procedurës para gjykatës së shkallës së parë pasi ky aktvendim i vjetër i Gjykatës Ekonomike në Prishtinë i vitit 1992 ka qenë në dispozicion të paditësit. Por, ai nuk e kishte prezantuar atë dokument para Kolegjit të Specializuar edhe pse në urdhrin e 10 shtatorit 2013 është urdhëruar që të paraqitet ndonjë dëshmi e cila do të kishte dëshmuar se autorizimi është lëshuar në mënyrë të rregullt nga personi i autorizuar ashtu që të shërbejë për qëllimin e parashikuar me ligjin e aplikueshëm.”

“... Theksi i cili është vënë në cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes, ndërkohë që kjo nuk është konfirmuar me dëshmi konkrete, nuk është i mjaftueshëm, prandaj, gjykata me të drejtë kërkoi që me prova konkrete të sqarohet nëse personi i cili e lëshon autorizimin ka qenë i autorizuar me dokument sipas ligjit të aplikueshëm...”

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesëpadinë në të dyja shkallët e vendosjes për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të paditësit, e kanë shkelur “të drejtën për qasje në gjykatë” dhe të drejtat e garantuara me nenet 24, 31, 32, 46, 54, 159 dhe 160 të Kushtetutës, si dhe nenet 6, 13 dhe 14 të KEDNJ-së dhe pikën 1 të Protokollit I të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të “shpall kërkesën të pranueshme... dhe që në bazë të shkeljes së konstatuar të të drejtave të njeriut të urdhërojë AKP-në... të vërtetojë se janë shkelur të drejtat pronësore të paditësit dhe ta detyrojë AKP-në” t’ia kompensojë dëmin për shkak të drejtave pronësore të shkelura dhe t’ia caktojë dëmshpërblimin për pronën, siç është paraqitur në faqen 17, nënparagrafin III, të kërkesës së parashtruesit para Gjykatës Kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parashikon:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

28. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

29. Gjykata vëren se parashtruesi në thelb e ka bazuar kërkesën në *“shkeljen e së drejtës për qasje në gjykatë”* dhe se të gjitha shkeljet e tjera të Kushtetutës, të cilat parashtruesi i thekson në kërkesë, rrjedhin për shkak të vendimit të gjykatave të rregullta që të refuzojnë kërkesëpadinë për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të paditësit.

30. Më tej, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në procedurën para gjykatave të rregullta ka vepruar si drejtor i *“SH.P.K. Tabak”*, duke tentuar të përfaqësojë personin juridik dhe interesat e 31 punëtorëve, si aksionarëve të kësaj ndërmarrje.

31. Derisa parashtruesi para Gjykatës Kushtetuese e ka paraqitur kërkesën si person fizik, duke theksuar se me profesion është pensionist, njëkohësisht ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese zgjidhjen e çështjeve pronësore që u përkasin personave të tretë (aksionarëve të tjerë).

32. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për *“shkeljen e së drejtës në qasje në gjykatë”*, ku ai si drejtor ka tentuar të përfaqësojë personin juridik *“SH.P.K. Tabak”* dhe interesat e 31 punëtorëve, si aksionarëve të kësaj ndërmarrje, nuk janë të sakta, sepse më 31 shtator 2013, DHPGJS urdhëroi parashtruesin e kërkesës të *“prezantojë autorizimin me të cilin e autorizon përfaqësuesin e tij në procedurën para DHPGJS-së, si dhe dëshminë se*

autorizimi i tillë është lëshuar nga personi i cili është i autorizuar për këtë sipas ligjit të aplikueshëm”.

33. Parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që në procedurën para DHPGJS-së t'i paraqesë dëshmitë me të cilat do të kishte dëshmuar se ai ka autorizimin për të përfaqësuar personin juridik “SH.P.K. Tabak” dhe aksionarët e tjerë. Një gjendje e tillë faktike është konstatuar me Aktvendimin (nr. C-I-12-0004 të DHPGJS-së), të 29 janarit 2014.
34. Gjykata Kushtetuese konstaton se Aktvendimi i DHPGJS-së (nr. C-I-12-0004) dhe Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (nr. AC-I-14-0044), japin një përgjigje të arsyetuar përse parashtruesi i kërkesës nuk posedon legjitimitetin aktiv për të përfaqësuar personin juridik “SH.P.K Tabak” dhe aksionarët e tjerë.
35. Më tej, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për “*shkeljen e së drejtës për qasje në gjykatë*” të tij, si personit fizik dhe pronarit të një numri të caktuar të aksioneve të cilat i ka fituar me transformimin pronësor gjithashtu nuk janë të sakta, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i kishte bashkëngjitur dëshmitë se ai ka tentuar që këto të drejta t'i realizojë në procedurën para gjykatave të rregullta.
36. Parashtruesit të kërkesës, si dhe aksionarëve të tjerë, të cilët parashtruesi i ka përmendur në kërkesë, u është dhënë mundësia për t'i paraqitur këto kërkesa të tyre në procedurën para AKP-së, e cila me njoftimin e datës 23 maj 2013, “*ftoi të gjithë personat që pretendojnë se kanë të drejtën e kërkesës apo interesit ndaj kësaj ndërmarrje apo asetit të ndërmarrjes t'i paraqesin dëshmitë e kërkesës, duke filluar prej datës 17 qershor 2013 deri më datën 31 korrik 2013*”.
37. Më tej, Gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e shkeljeve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së të cilat i thekson parashtruesi, e të cilat në thelb rrjedhin nga shkelja e së drejtës për qasje në gjykatë sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës nuk janë të sakta dhe janë në kundërshtim me dokumentacionin të cilin parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë.
38. Gjykata rithekson që, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat ligjore përkatëse (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih, gjithashtu, Rastin nr. KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
39. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur, kryesisht, me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të ligjshmërisë.
40. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

41. Gjykata, në vazhdim theksoi se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t'i jep të drejtë të ngrejë një pretendim të argumentuar për shkeljen e Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
42. Parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që të paraqes rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, si gabimisht të interpretuar, para AKP-së, DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në procedurën e rregullt gjyqësore.
43. Gjykata, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
44. Gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.
45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

46. Siç është theksuar edhe më lart, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *"Të lëshojë masën e përkohshme me të cilën Gjykata do të suspendojë procedurën e likuidimit në mënyrë që të shmangët shkaktimi i dëmit të pariparueshëm"*.
47. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, nevojitet që:

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; ose
(...)

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

48. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme. Për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të hidhet poshtë.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi